

## **AKT THEMELIMI**

Sot ne dt. 08 Prill 2024 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues",

**LUAN GJINIKA**, i datelindjes 05/06/1965, i lindur ne Sarande dhe banues ne Sarande, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit me nr. G50605057H ,leshuar nga MB me date 09/01/2024,i cili me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin **DEA DELVINO MERLOT** shpk.

### **KREU I**

**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti**

#### **Neni 1**

#### **Emertimi**

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **DEA DELVINO MERLOT** shpk. Shoqëria do të nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakut themelues.

#### **Neni 2**

#### **Forma Juridike**

Shoqëria **DEA DELVINO MERLOT** shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria"). Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria **DEA DELVINO MERLOT** shpk, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut i vetëm që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

#### **Neni 3**

#### **Selia**

#### **Shoqëria e ka selinë në adresën:**

**DELVINE, Lagjja Kallapodh, godina me Nr. Pasurie 1464, Zona Kadastrale 2/60.**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm.

#### **Neni 4**

#### **Objekti i veprimtarisë**

**Agrobiznes. Agroturizem. Suvenire. Ambjente argetimi.**

#### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

### **KREU II**

#### **KAPITALI**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise. **Z. LUAN GJINIKA**

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte **100.000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **100.000 Leke**, eshte paguar nga ortaku themelues.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku i vetem themelues pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

#### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

### KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

#### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

#### Neni 9

#### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem.

Administratore e shoqerise eshte emeruar **REMZIE GJINIKA**, e datelindjes 08/04/1945, e lindur ne KONISPOL dhe banues ne Sarande, shtetase shqiptare, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit me nr. E55408052H ,leshuar nga MB me date 15/01/2021. Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjisllacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

#### Neni 10

#### Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund të injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për

të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKR, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqërise tregtare **DEA DELVINO MERLOT** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE**

**LUAN GJINIKA**